

DAVID LUKA

MARTIN CAMAJ – MJESHTËR I FJALËS SHQIPE

Martin Camaj është malësor *i thekur*, lindur e rritur në malet e Veriut të vendit, ku ka kaluar fëmijërinë. Ai, me gjithë arsimin e kulturën e marrë jashtë vendi, ruan në gene prejardhjen e vet, të cilën ose e ndërkall, ose e pasqyron në veprën letrare.

Ai punon me ngulm e në mënyrë të ndërgjegjshme për ta pasuruar gjuhën shqipe, natyrisht sipas parimeve e kriterëve që i ka vënë vetes.

M. Camaj krahas përgatitjes klasike, është edhe studiues i gjuhës shqipe, i asaj diakronike dhe sinkronike. Veprat e tij në fushën e gjuhës së sotme dhe asaj historike¹, do t'i japin krah autorit të tregohet tepër racional në përzgjedhjen e leksikut të veprës së vet letrare. Këtë rrugë ai e realizon në disa mënyra.

- *Së pari*, duke ringjallur e futur në përdorim ndonjë fjalë nga autorët e vjetër të shqipes (khs. *i parilemë*, marrë nga Buzuku *i parilenë*, lat. *primogenitus*, me të njëjtin kuptim).

- *Së dyti*, duke përdorur me saktësi e rigorozitet fjalë të krahinës ku ka lindur e ku ka kaluar fëmijërinë. Vetë tema e zgjedhur (në prozën e marrë nga ne për analizë e vjelje të leksikut), i jep dorë për ta bërë shumë mirë këtë punë. Ngjarjet e prozës “Pishtarët e natës” zhvillohen në një vend që quhet *Fundina* (pra diku në një *fund* të Veriut të vendit), ku banorët e atjeshëm janë krejtësisht të veçuar nga bota. Në gojën e këtyre personazheve (veçanërisht të Nikës e të Lenës) autori vë fjalë të vjetra të krahinës, por të përdorura me një saktësi të habitshme e me një kuptim që

¹Vetëm vepra gjuhësore e M. Camajt përfshin: 1. 10 punime monografike; 2. 29 studime dhe artikuj për probleme gjuhësore; 3. 19 recensione për vepra të ndryshme gjuhësore (shiko L. Konomi, *Bibliografi e veprës së Martin Camajt dhe shkrimeve për të*, “Studime filologjike, nr. 1-4, 1996, f. 179 v.)

T. Osmani shënon: “Veprimtaria gjuhësore e Martin Camajt është mjaft e pasur dhe me shumë interes, por jo shumë e njohur pasi është në gjuhë të huaj ... vepra e tij edhe në aspektin gjuhësor paraqet vlera të veçanta. Ajo duhet të studiohet me përparësi të veçantë dhe të popullarizohet që të njihet më mirë nga lexuesit dhe studiuesit” (“Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor” 3, Shkodër 2009, f. 245).

nuk lë asnjë shteg për dyshime a dyzime. Këto fjalë mund të shërbejnë edhe për të kontrolluar fjalorët, që në disa raste nuk u japin kuptimin e saktë.

- *Së treti*, Camaj u jep kuptime të reja (shpeshherë edhe të figurshme) fjalëve të rralla; u jep atyre jetë e gjallëri, duke i bërë të përdorshme edhe për gjuhën e sotme shqipe.

- *Së katërti*, krijon neologjizma, po me nuhatjen e një gjuhëtari të pjekur dhe gjithnjë në natyrën e gjuhës shqipe².

- *Së pesti*, ai është ngritur jo vetëm mbi të folmen e krahinës, por edhe mbi vetë gjendjen e gegërishtes së kohës së vet. Gjuha e tij tani pranon edhe trajta foljore që nuk i ka e nuk i përdor as krahina ku zhvillohen ngjarjet e as dialekti gegë në përgjithësi (khs. *shkonim* për *shkojshim* etj.). Ë-ja atone përdoret rregullisht sipas normës së gjuhës shqipe standard. Kështu vepron ai edhe për raste të tjera të kësaj natyre³.

Përgjithësisht mund të themi se gjuha e veprave të Camajt (së bashku me *Gramatikën*⁴), mund të shërbejnë edhe sot e kësaj dite si gjedhe për një gegërishte letrare, për të cilën bën përpjekje të ndërgjegjshme për ta ngritur në rangun e një kryedialekti, të një koineje letrare të mirëfilltë, duke dhënë tani edhe ndihmesën e vet për standardizimin e saj⁵.

* * *

²Në fund të romanit *Rrathë*, botim i shtëpisë botuese “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2001, është vënë një *Fjalorth* me afër 300 fjalë të rralla, që shërbejnë për të kuptuar më mirë mendimet e autorit dhe për të bërë një lexim pa pengesa të tekstit.

³Një analizë të shkurtër, por të ngjeshur për rastet, për të cilat po flasim, do ta gjeni te artikulli i K. Topallit *Vepra e Camajt në aspektin gjuhësor*, në vëll.

“Martin Camaj - Tradita dhe bashkëkohësia”, Shkodër, 1994.

⁴M. Camaj, *Albanian Grammar ...*, Wiesbaden, 1984.

⁵Në një letër, që Camaj i dërgon Gjon Sinishtës nga Mynihu e që mban datën 27 mars 1991, shkruhet, ndërmjet të tjerash: “Prej 1952 e kam ndjekë kambë për kambë zhvillimin apo imponimin e tosknishtes si gjuhë zyrtare. Nuk kemi polemizue fort, por jemi përpjekë ta përfekcionojmë gegnishten, tue u mbështetë në tekstet e vjetra tona, tue i dhanë gegnishtes vendin që i përket kurset universitare. Pa modesti e për hir të vërtetës shfaq i se kontinuitetin e përdorimit të gegnishtes letrare në poezi, prozë artistike dhe ekspozitive ... mbas mbylljes së *Shëjzat* (1975) me plot vetëdije e çova përpara unë, vepra e fundit letrare në këtë variant të shqipes asht *Palimpsest* (München New York 1991). S’po hy me levdue veten në gjurmime gjuhësore, por po vë në dukje *Albanian Grammar*, që përdoret si tekst kudo në prenim në mësimin e shqipes në universitete, bile edhe në Bashkimin Sovjetik”. (“*Hylli i dritës*”, nr. 1-2, Tiranë, 1996, f. 76).

Vepra e Camajt paraqet interes të veçantë studimi edhe për gjuhën shqipe, e veçanërisht për leksikun e përdorur aty. Prej kësaj ne kemi marrë për analizë prozën “Pishtarët e natës”⁶. Aty kemi përzgjedhur 294 fjalë të rralla, prej të cilave 101 nuk dalin në *Fjalorin* 1980. Përpjesëtimi këtu është 34.3%. Nga këto 101 fjalë ne kemi ripërzgjedhur 30 fjalë, që sjellin një ndihmesë të madhe në pasurimin e gjuhës letrare shqipe, sepse ky, përveçse shkrimtar i madh, është edhe gjuhëtar i përgatitur mirë. Pra, ai nuk i lëshon fre fantazisë, kur ndërton fjalë të reja, përkundrazi punon me logjikën e sistemit të një gjuhëtari, duke i kryer këto ndërtime në natyrën e gjuhës shqipe. Khs. *arnyell*, *bestytëse*, *derk*, /i/ *fatuem*, *festore*, *fjalëmbarë*, *fshehsiplohtë*, *fundinë*, *gjysmëterr*, *hekurar*, /i/ *kapërthym*, /e/ *kokërrueme*, *lëkurëremët*, *lukshtjerrë*, *malemal*, *mjegullazë*, *mrekullbamës*, /i/ *pambërritshëm*, /i/ *parilemë*, /i/ *përbotun*, /me u/ *përnjësue*, *rrasatik*, *rrogacë*, *shpërgojim*, /i/ *shtjerrun*, *thatas*, *vutas*, *zhurore*. Këto fjalë janë nxjerrë vetëm nga 62 faqe prozë. Vetëkuptohet se numri i tyre do të shumëfishohej po të analizohej e gjithë vepra e tij në poezi e prozë e në studimet të tjera shkencore.

Për të vërtetuar që Camaj punon me fjalën si gjuhëtar, shërbejnë këto shembuj. Për fjalën *arnë-ni* (sh. *arnenj-të*) “lloj pishe” (të *Fjalorit* 1980⁷), Camaj jep trajtën e saktë të njëjësit *arnyell* (“e quente Nikën *arnyell* i *vetmuem*, mes ashtës, *pa arnej të tjerë pranë*”⁸). Fjalën *qenës-i* e ndërton sipas hollisë së fjalëformimit të gjuhës shqipe nga folja *qenë* me prap. -/ë/s, në ngjasim me emrat e tjerë prejfoljorë si *blerës*, *korres*, *mbjellës* etj.⁹ Folja /me u/ *përnjësue* ka kuptim të diferencuar nga *njësuj*. *Me u njësue* do të thotë “me u bâ një”, ndërsa /me u/ *përnjësue* “me u vû në rresht a në radhë për një”. Camaj nuk shkruan /me u/ *njisue*, por /me u/ *njësue* (një të gjuhës standard, në vend të *nji* të gegërishtes). Fjalën *lukshtjerrë*, që do të thotë “grua që nuk lind; që është me luk të shtjerrë; me luk të shqyer”, e ndërton në mënyrë të përkryer si kompozitë ekzocentrike me vlerë pronësore (që krahasohet me bahuvrihit indoeuropiane) brenda strukturës së gjuhës shqipe, duke dhënë një fjalë të re që nuk e ka jo vetëm *Fjalori* 1980, po as vetë leksiku i gjuhës shqipe të sotme. Mbiemri /i/

⁶M. Camaj, *Shkundullima* (proza), Romë, 1981 (*Pishtarët e natës*, f. 7-69).

⁷*Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 53.

⁸Po aty, f. 23.

⁹Për funksionin e kësaj prapashtese, shiko te Xhuvani-Çabëj *Prapashtesat*, në vëllimin “A. Xhuvani” (Vepra I), Tiranë, 1980, f. 479.

prishakandun ndërtohet mbi bazën e *mirakande* të cilën, megjithëse gegizëm e pastër, e ka pranuar edhe *Fjalori* 1980¹⁰.

Pas këtij parashtrimi vetiu lind pyetja, përse autorët e *Fjalorëve* të gjuhës shqipe (1980, 1984, 2006 etj.) nuk i kanë përfshirë (përkat. i kanë përjashtuar) këto fjalë nga thesari i gjuhës shqipe. Nuk kanë ditur, apo nuk kanë dashur?

FJALORTH
I FJALËVE TË RRALLA NË PROZËN “Pishtarët e natës”¹¹
TË MARTIN CAMAJT

am/ë-a (20, 25, 64) “erë e mirë ose e keqe, që të vjen ndër hundë kur nuhasim diçka, ose kur sendi lëshon vetiu një aromë të veçantë”.

amvis/ë-a (25) “zonjë shtëpie”.

andj/e-a (37) “kënaqësi e veçantë”.

ankth-i (47) “gjendje pasigurie dhe frike për çfarë do të ndodh; stres”.

arnyell-i (23) “lloj pishe (*Pinus excelsa*), molikë”; shumës *arnej*.

avlimend-i (26) “*avləmend*, tezgjah, vegë”.

baglim-i (33) “veprimi sipas kuptimit të foljes *bagëloj*”.

bat-i (22) “një lloj gracke, e bërë me degë të holla, që përdoret për të zënë zogj”.

berr-i (12) “kryesisht bagëti e imët”.

besëlidhj/e-a (22) “marrëveshje për të përkrahur e mbrojtur njëri-tjetrin”.

bestytëse (64) “bestytësi”, te Camaj e përdorur si mbiemër (khs. *paragjykime bestytëse*), me gjasë neologjizëm e krijuar nga vetë autori.

bjerraditës-i (40) “ai që sillet tërë ditën pa punë, ai që bjerr ditën, sallahan”.

blan/ë-a (68) “shenjë në trup, e shkaktuar nga gërvishjet e kafshëve të egra gjatë gjuetisë së tyre”.

bush-i (41) “(*Buxus sempervirens*), bimë në formë shkurreje e gjithmonë e blertë; shimshir”.

cakërr (58) “copëza akulli të ngrira përmbi dëborë”.

cikërr (58) “zhigla, copa të vogla yndyre e mishi, të skuqura shumë, që i hidhen pulendrës për ta mëlmyer atë; copëzat e vogla, që mbeten kur tresim ushuj derri”.

cikërrime (29, 55, 58, 64) “sende të vogla; punë të vogla e të bezdishme”.

curr-i (10, 16, 64) “shkëmb i lartë e i thepisur, që ka pamje të hapët”.

curril (20) “rrjedhë e vogël uji”.

çak/ë/l-a (29) “sende të vogla, gjithsesi pa ndonjë vlerë të madhe”.

¹⁰*Fjalor* 1980, f. 1142.

¹¹M. Camaj, *Pishtarët e natës*, në përmbledhjen “Shkundullima” (Proza), Romë, 1981, f. 7-69.

çapue - çapoj (10) “një lloj thoi që kanë disa shpendë pas këmbëve”.

çub/ë-a (25, 46, 63) “kaçubë”.

delm/e-ja (9) “dele”.

derk-u (61) “zog thiu”.

dervend-i (59) “grykë mali”.

djerritun (i, e) (8) “tokë ose arë e lënë djerrë”.

dok/e-ja (32, 39, 69) “mënyrë jetese; zakon”.

dordolec-i (56) “surrat që vihet në arë për të trembur zogjtë dëmtues”.

drejtaz (32) “drejt”.

dures/ë-a (66) “durim-i”.

faculet/ë-a (28) “*facoletë*, shami (zakonisht e kuqe) që vënë malësoret në kokë, ose e lidhin për brez”.

fatueme (e) (20) “kështu mbiemërohen shtojzovallet, ngjan për të mos ua përmendur emrin” (*eufemizëm*).

fejz/ë-a (57, 64) “fije të holla”.

feks-i (19, 26) “ndriçimi i rrezeve të diellit; refleksi i tyre”.

ferlik-u (12) “berr i pjekur në hell”.

festore (21) “*mb. petka festore*, që vishen për festë”.

fitm/e-ja (27) “*me shtî fitme* ‘me shtî ngatërresa’; intriga”.

fjalëmbarë (22) “që flet mbarë; që e ka fjalën e mbarë”.

fjoll/ë-a (57) “fije të holla”.

fleg/ë/r-a (58) “*flegurat e hundës*, fejet e hundës”.

flijuem (i) (34) “që flijohet. që bie flijë”.

forcaj/e-a (25) “forcë, forcade, fuqi”.

fshehtësiplotë (26) “*mb.*, që janë në fshehtësi të plotë”.

Fundin/ë-a (11) “emërtim vendi nga fjala *fund* me prap. -inë”.

fytafyty (16, 17, 20) “*ndf. fytas*”.

gac/ë-a (44) “thëngjill i ndezur”.

galuc (48) “*galiç*, i ulur me këmbë të përkulura”.

gëvosk/ë-a (25) “dritare e vogël, e zgavërruar në mur pranë oxhakut (ndër shtëpi malësore), ku i zoti i shtëpisë mbante enët e kafesë”.

gojash (49) “që i mbahet goja”.

grithj/e-a (68) “gërvishtje”.

guralec-i (17) “gur i vogël”.

gzhatë (me) (15, 24) “me ngá, me ngacmue, me guxitë”.

gjakasan/ë-a (58) “një lloj sallami që mbushet me gjak bagëtie të therur”.

gjalm-i (14) “lidhëse opingash; *përgjith.* lidhëse”.

gjalmise (59) “shum. i *gjalm-i*”.

gjallnes/ë-a (19, 57, 61) “jetë-a”.

gjamim-i (48, 55) “*gjëmim*, që gjëmon”.

gjamatar-i (67, 68) “ai që vajton të vdekurin”.

gjam/ë-a (10) “*gjëmë*, fatkeqësi, rrezik i madh, mynxyrë”.

gjysmëterr-i (29) “gjendje ndërmjet dritës e territ; mugët”. (Neologjizëm i krijuar nga vetë autori).

hatull-a (66) “pjesë e ndërtesës ndërmjet trarëve e pullazit”.

hejz/ë-a (61) “akull i ngrirë ndër degë në formë stalaktiti”.

hekurar-i (38, 49) “ai që punon hekurin; farkëtar”.

hell-i (12) “dru me majë të mprehtë, në të cilin piqet fërliku duke e rrotulluar rreth zjarrit”.

hep-i (17, 20) “plasë në shkëmb”.

heshtue (me) (23, 32, 38, 44) “me heshtë”.

hullí-ja (61) “vijë e hollë dhe e gjatë”.

hurp-i (25, 40, 63) “hurm, hurbë, gllënjë”.

idhní-ja (23) “zemërim; mëri”.

idhtësí-ja (32) “shije e hidhur; të përzier”.

jerm-i (58, 60) “përçart, kllapi”.

kacavarë (me u) (17) “me u ngjitë në një pemë a diku tjetër me këmbë e me duar”.

kaç/ë-a ((59) “kokërr bime, që hahet e njomë”.

kajz-i (11, 12, 36, 37) “kallëz”.

kakërdhi-a ((19) “jashtëqitjet e dhive”.

kallçik-u ((59) “kalca; lloj çorapeje leshi pa shputë, që vishen kur udhëton nëpër borë”.

kallm-i (28) “kallçik”.

kamin-i (63) “oxhak nga del tymi i zjarrit të ndezur në vatër të një shtëpie”.

kapërthyer (i) (15) “i mbërthyer mirë në të gjitha anët”.

karm/ë-a (34) “shkëmb i mprehtë thikë, zakonisht buzë një lumi”.

katallan-i (14, 28) “ciklop me një sy; div”.

kaví-a (43) “shkak; burim i një ngjarjeje”.

kep-i (17) “shkëmb i mprehtë, thep”. Te Camaj “vegël për me kepë”.

këmes/ë-a (10, 38) “vegël si kallë, që përdoret për të prerë ferra etj.”.

kërcun/ë-a (35) te Camaj me kuptimin “e mjera”.

kithi (për së) (18) “përtërthuer”.

kokërrueme (e) (13) “e bërë kokrra-kokrra”; te Camaj e përdorur për “shtëpi që janë larg njëra-tjetrës, *shtëpí të kokërrueme brijash e luginash*.”

komit/ë-a (27) “njerëz të jashtëligjshëm, që marrin malet për t'i shpëtuar ndjekjeve të qeverisë”.

konop-i (35) “litar”.

korp-i (64) “trupi; trangu”.

korsull-i (53, 54) “konsull”.

kor/r/ë-a (29, 32) “të korrurit”.

korril/ë-a (53) “kojrilë, kurilë; lloj shpendi”.

koshar/e-ja (29) “shportë; kosh”.

krahnjerr-i (61) “lloj bime që bën kokrra të vogla; grathtel”.

- krahol-i** (47) “lloj veshjeje pa mëngë; jelek”.
- krej/ë-a** (27) “kryet /e vendit/”.
- krep-i** (18, 26) “shkëmb, shkrep”.
- kresht/ë-a** (19, 40) “kurriz mali”.
- kryekcyem** (23) “që rrëmbehet shpejt; që punon në kokë të vet e pa pyetur të tjerët”.
- kudh/ër- a** (38, 39) “vegël e farkëtarit ku rrihet hekuri i skuqur”.
- kue (me)** (7) “me i dhanë fëmijës gj”.
- kulloshtër-a** (64) “qumështi që del nga bagëtia që sapo ka pjellë”.
- kular-i** (31) “dru i kthyer që përdoret për të mbrehur qetë”. Te Camaj *si gjarpni që mblidhet kular*.
- kumt-i** (67) “lajmërim vdekjeje; lajm i zi”.
- kundrue (me)** (14, 23, 52, 60) “vështroj me vëmendje”.
- kuresht/ë-a** (17, 67) “kërshtëri”.
- kurm-i** (13) “trup, *ata ishin si ... kurm i vetëm*”.
- kurth/ë-a** (59) “lloj vegle për të zënë shtazë e bisha të malit”.
- lagësin/ë-a** (20, 67) “vend i lagësht”.
- lajk/ë-a** (25) “lëvdatë që bëhet për servilizëm e për të nxjerrë ndonjë dobi prej saj”.
- lal/ë-a** (28) “emërtim në shenjë respekti i një më të madhi se vetja”.
- lavdat/ë-a** (12) “lavdërim”.
- leqe-t** (58) “lloj gracke për të zënë kafshë a shpendë të egër në pyll”.
- lëkurëremët** (45) “ai që e ka lëkurën në ngjyrë të murrme”. Ngjan si kompozitë *lëkurë + remët (rem-i “bakër”)*, neologjizëm i krijuar nga vetë autori.
- lënurun (i)** (59) “i shprishur, i krehur me gërhanë (*lesh i lënurun*)”.
- lëpush/ë-a** (20) “bimë me fletë të mëdha” (*Petasites officinalis*).
- lëvyrë (me u)** (31, 39) “me iu përshpirt diku; *lëvirem*”.
- ligështí-a** (24, 32) “mungesë guximi, mungesë burrërie për të thënë a mbrojtur diçka”.
- lok/e-ja** (67) “emërtim i nënës në formë përkëdheljeje”.
- lukshtjerrë** (28) “sterile, që nuk bën fëmijë”. Kompozitë e formuar nga *luk* “lug” + *shtjerrë* “e shqyer”. Ngjan të jetë neologjizëm i krijuar nga Camaj.
- lurtue (me)** (56, 66) “me miklue; me bâ lajka; me përkdhelë”.
- lloç-i** (50) “baltë e përzier me gëlqere, që shërben për të lidhur murin”.
- llull/ë-a** (41) “çibuk i bërë me dru bushi”.
- madhosh** (63) “i madh në trup, *shpend madhosh*”.
- maj-i** (17) “lloj çekani i rëndë për të thyer gurë të mëdhenj”.
- malemal** (50) “*ndf.* që është i shtrirë nga njëri mal te tjetri; që është i ngritur nga njëri mal te tjetri”, te Camaj për të përcaktuar ngritjen dhe shtrirjen e lumit; *lumi i Vilës ishte i rritun malemal*. Kompozitë e krijuar nga vetë autori *mal e mal, e-ja* zanore lidhëse.
- mardhun (i)** (61) “i mërdhitur”.
- mashtap/ë-a** (65) “enë, zakonisht përdoret për ujë”.

- mbërrelë (me u)** (36, 44) “me u vërejtë në fytyrë; me u zymtue në fytyrë; me u ngrysë në fytyrë”.
- mbërrelshëm** (22) “i vrenjtur; i zymtuar; i ngrysur”.
- mëgoj/ë-a** (35) “racion; pjesë e caktuar, që i lidhet dikujt për të përballuar jetesën, i lidhim gojën prej 300 kile misër”.
- mëllez/ë-a** (17) “lloj druri” (*Ostrya carpinifolia*).
- mërdhitë (me)** (25) “me pasë ftohtë; me e ndie të ftohtit shpejt”.
- mis-i** (21, 22) “pjesë e trupit të njeriut, *miset e fytyrës*”.
- mjegullaz/ë-a** (26) “mjegull e lehtë”.
- mjeshtër (me)** (38) “me punue me rregull; me punue për së mbari; me punue me sistem”.
- mre-u** (38) “dru prej mreut, që u vihet si bisht veglave të punës”.
- mrekullibamës~e** (33) “që bën mrekulli, *hajmali mrekullibamëse*”. Neologjizëm krijuar prej vetë autorit; kompozitë nga *mrekulli* + *bamës*.
- mungullore** (61) “që ka filiza; që përtërihet, *shtresë mungullore*”.
- murriz-i** (10) “lloj shkurreje me gjemba” (*Crataegus*).
- murrilan-i** (46) “erë e ftohtë; veri, murrë”.
- naf/e-ja** (60) “*nafele*, larë e bardhë në lëkurë të shqerrit”.
- ndej/ë-a** (39) “mënyra se si rri një njeri, si sillet etj.”.
- ndeshtrash/ë-a** (9) “halle, telashe, *ndeshtrashat e jetës*”.
- ndërdyzash** (14) “me dyshim”.
- ndij/ë-a** (13, 55) “ndjenjë-a”
- ndjellakeq~e** (20) “ai që ndjell keq”.
- ndragë (me u)** (66) “me u fëlliqë; me u ndye, *ndotu e ndragu*”.
- ndërroje** (8) “që ndërrohen, *tesha ndërroje*”.
- nemë (me)** (10) “me namë; nëm; mallkoj”.
- nergut** (25) “me qëllim”.
- ngashrue (me u)** (18) “mallëngjehem; prekem në zemër”.
- ngucë (me)** (39) “ngacmoj; nxit (për të keq)”.
- ngurrë (me u)** (8) “me u shtangë; me u bâ si gur”.
- njohësi-a** (17) “të njohur; njohuri”.
- ogurzezë** (20) “që ndjell zi”.
- opang/ë-a** (10) “opingë”.
- pafjalë (i)** (16) “që nuk flet shumë e kur nuk duhet; që shikon punën e vet”.
- pallavra** (47) “fjalë boshe; fjalë të kota; gjepura”.
- pambërritshëm (i)** (26) “që nuk mbërrihet, që nuk arrihet dot”.
- papashëm (i)** (16) “që nuk shihet; që është i padukshëm”.
- paque (me u)** (9) “me u qetësue; me ra në paqë; me ra në qetësi”.
- parahymje** (33) “nisja, fillimi i një mendimi”.
- parilemë (i)** (7, 35) “djali që ka lindur i pari në një shtëpi”. Kjo fjalë, e përdorur te Buzuku (*i parilenë*, lat. *primogenitus*), është ripërdorur (përkat. ringjallur) te Camaj.

- parzëm** (9, 23, 28, 41, 55, 68) “kraharor, gjoks”.
- pec/ë-a** (60) “rrip i gjatë pëlhure që përdoret për të lidhur plagët”.
- pendël-a** (57) “pupël”.
- përbindshëm (i)** (20) “që është i stërmadh dhe i frikshëm; diçka e shëmtuar”.
- përbotun (i)** (67) “i ndotur me bot” (*bot-i* “një lloj dheu me ngjyrë të zezë që përdoret për të lyer muret etj.”).
- përbujtë (me)** (32) “me pritë miq e të huaj për të kaluar natën në shtëpi”.
- përgojim-i** (13, 15) “të marrurit nëpër gojë”.
- përgojue (me)** (40) “prozhmoj; marr nëpër gojë tjetrin pa arsye”.
- përjetue (me)** (20, 40) “jetoj në mënyrë të thukët; jetoj me intensitet veprimesh”.
- përlevdue (me)** (23) “me lavdërue”.
- përmallue (me u)** (28) “mallëngjehem”.
- përngeshëm (i)** (37) “që ka punë pak; që ka nge”.
- përnjësue (me u)** (10) “me u bâ një me mjedisin ku jeton”.
- përspjet** (9) “vjen papritur e pamenduar; vjen në beft”.
- përtrollë (me)** (13, 40) “me e shtrive për truall”.
- përthithë (me)** (61) “me thithë me intensitet”.
- pirolla** (39) “*përshëndetje*, i lumtë”.
- pjalm-i** (59) “borë e thatë dhe e imët”.
- plang-u** (13, 16, 38) “përgjithësisht tërësia e pasurisë së patundshme e një familjeje malësore”.
- poç-i** (24, 31) “enë që përdoret kryesisht për të mbajtur raki”.
- prishakandun (i)** (44) “i prishur qejfit; i prishur kandjet”.
- prore** (42, 43, 45) “për gjithë orë; pa kohë të caktuar; në çdo çast”.
- prozhëm-i** (47) “pyll i vogël pranë shtëpie, ku priten drurët për zjarr”.
- pshërtues** (19) “i përvaishëm, *tingull psherëtues*”.
- puc-i** (50) “që bie lehtë, që shkëputet lehtë”. Kemi këtu një emërzim të mbiemrit *puc* (*fik puc* “fik rrek, fik që është pjekur shumë, prandaj edhe këputet lehtë e bie përtokë”).
- pulendër-a** (61) “kaçamak, mëmëligë”.
- punëmadh** (45) “që mburret se bën punë të mëdha”.
- qenës-i** (26) “njeri që është, që ekziston”.
- qes/e-ja** (19) “trastë e vogël për të mbajtur duhanin”.
- qet/ë-a** (29, 35, 41) “shkëmb me thepa”.
- qëth-i** (13) “*qehën*, *qer*, dërrasë e rrumbullakët me bisht të gjatë, ku vihet buka për ta futur në furrë”.
- rangë-t** (8, 9, 45, 54, 58, 64) “punët e rëndomta të shtëpisë”.
- reshë (me)** (59) “me ra borë”.
- rig-u** (61) “vesë shiu, *rig shiu*”.
- rog/ë-a** (19, 41) “fushë majë shkëmbi; fushë alpine”.
- rub/ë-a** (59) “shami koke që e përdorin kryesisht gratë”.
- rrabe** (11, 12, 44) “që nuk jep fryt, *tokë rrabe*”.

- rrabush-i** (53) “*na ven në rrabush, na vë në lojë; na tallë*”; *r/r/abush-i* “mashkulli i qepës”.
- rraqe-t** (38) “*rrangulla shtëpie, pa vlerë të madhe*”.
- rrasatikë-t** (33) “*gurë rrasikë; gurë shpatukë; petashuqa*”.
- rrejtë (me u)** (49) “*me u gënjye*”.
- rreng-u** (52) “*dëm që i bëhet tjetrit: hak inati, tinëz e me djallëzi*”.
- rreshk-u** (13, 14) “*dëshirë e fortë për të pasur diçka; dëshirë e fortë për të ngrënë e për të pirë, të shuente rreshkun e tërbuem*”.
- rreshk/ë-a** (58) “*syprina e ashpër e borës*”.
- rreshp** (18) “*lloj guri, rrasat e gurit rreshp*”.
- rreshpe** (11, 18) “*rreshp*”.
- rrëshiq-i** (39) “*gjyryku i kovaçit; mjeti që përdor kovaçi për t’i fryrë eshkës*”.
- rrisk-u** (62) “*fat-i*”.
- rrogac/ë-a** (34) “*rryp /lëkure/, rrogacë lëkure*”.
- rropullí-të** (61) “*të brendshmet e bagëtisë, derrit etj.*”.
- rropullim/ë-a** (48) “*zhurmë e madhe. rropullima e ujit*”.
- rrungaj/ë-a** (35) “*ortek bore*”.
- san/ë-a** (22, 55) “*bar i thatë; kashtë*”.
- sendegjâ** (16) “*gjësend*”; përngjitje nga *send e gjâ*.
- sendërtue (me)** (24) “*me sajue, me sendërgjue, Lena sendërtonte në krye të vet*”.
- skajim-i** (25) “*veprimi sipas foljes skajoj*”; këtu me kuptimin “*vë në vend të vet*”.
- skapullue (me u)** (55) “*shpëtoj nga një gjendje e vështirë dhe e padëshirueshme, të skapullohej ankthesh*”.
- sos/e-ja** (67) “*fund-i*”.
- sosë (me)** (25, 29, 31) “*i jap fund një pune etj., s’dinte ta soste kuvendin*”.
- strajc/ë-a** (18, 66) “*trastë*”.
- sukull-i** (37) “*lecka të mbledhura shuk, sukuj zhgunash*”.
- syhapët** (8) “*i habitur; i çuditur*”.
- shek/ë-a** (49) “*enë e drunjtë për të mbajtur kryesisht lëngje, bulmet etj.*”.
- shëmbllës/ë-a** (23) “*sende a parafytyrime që ngjasojnë njëra me tjetrën*”.
- shijueshëm** (25) “*me shije, i shkokërronte fjalët shijueshëm*”.
- shkas-i** (28) “*nxitje, hov, vrull, merrte shkas*”.
- shkarravitë (me)** (19) “*shkruaj keq prej të paditurit a pakujdesit*”.
- shkokërrue (me)** (25) “*e bëj kokrra-kokrra; i heq kokrrat, i shkokërronte fjalët*”.
- shkrol/ë-a** (53) “*shkronjë*”.
- shkuesí-a** (30) “*lajmësi*”.
- shkundullim/ë-a** (48) “*shkundëllimë-a, tërmet*”.
- shkulm-i** (48) “*valë ere, suvalë, shkulm ere*”.
- shllig/ë-a** (66) “*lloj gjarpri, nepërkë*”.
- shllim-i** (45) “*mendim, idé*”.
- shmang** (56, 57) “*vend a tokë e ndame prej të tjerash, i dinim shtigjet më në shmang*”.
- shpërgojim-i** (13) “*me folë keq për tjetrin; me i lëshue frë gojës*”.

- shpotitë (me)** (23) “me vu në lojë”.
- shqimth-i** (52, 59) “pragu i derës, në *shqimthin e kësaj dere*”.
- shtaz/ë-a** (17) “kafshë”.
- shtërri-a** (29, 62) “shtrrijakë; shqerra e keca së bashku”.
- shtirë (me u)** (34) “shtihem; bëj sikur më ...; tjetër bëj e tjetër mendoj”.
- shtjerr/ë-a** (41, 45) “shqerra”.
- shtjerrë (me)** (30) “me shkye; me zbledhë diçka të tjerrur”.
- shtjerrun (i)** (49) “i shkyem, *me za të shtjerrun*”.
- shtojzovallë-t** (15) “figura të besimeve popullore, që përfytyrohen si vasha shumë të bukura e që jetojnë të fshehura diku në pyll”.
- shurrqel-i** (20) “ujëvarë”.
- tagjisje** (58) “të dhënit ushqim, *tagjisjen e mëzatit*”.
- tangar-i** (37) “mangall”.
- tervez/ë-a** (67) “*trevezë*, tryezë buke; copë dërrase rrumbullake pa këmbë, që përdoret për të shtruar bukën në malësitë e Veriut të vendit”.
- tesh-i** (39) “send i vogël; ashkël e vogël që të hyn në sy”, te Camaj e përdorur si eufemizëm.
- tëhollue (me)** (13) “bëj të hollë diçka; stërholloj diçka”.
- tëhuej (me)** (28, 31, 60) “largoj diçka, e bëj të huaj diçka (kryesisht një njeri), *ia kishin tëhuej të shoqin*”.
- tinzar** (23) “që punon në fshehtësi”.
- tirq** (39) “lloj pantallonash prej shajaku”.
- tort/ë-a** (14) “lloj tërkuze, kryesisht e bërë me dega a fije degësh elastike”.
- tregtiz/ë-a** (37) “dyqan i vogël zejtar”.
- trev/ë-a** (42, 69) “kullotë e vogël malore ku kullosin qetë në pranverë”.
- trillues-i** (14) “ai që sajon gjëra të paqena”.
- trin/ë-a** (20) “një e thurme me degë, që vihet mbi oxhak ndër hatulla për të tharë mishin në tym”.
- true (me)** (10) “shaj, nëm”.
- trupazí-a** (68) “sëmundje e keqe; hidropizí-a”.
- turfullue (me)** (9) “me shfrye hundësh si kali; shqetësohem duke e shfaqur këtë shqetësim me shfryrje fjalësh etj.”.
- turr/ë-a** (55) “grumbull sendesh, zakonisht të një lloji”.
- thamët (i)** (45, 63) “që është i thatë nga trupi; që vjen i hollë e i pakët nga trupi; thatanik”.
- thashethana** (14, 24) “thashetheme; fjalë të shpifura, të thëna me qëllim të keq për të ngatërruar njerëzit”.
- thatas** (66) “*ndf.* në mënyrë të thatë; këtu e përdorur në mënyrë të figurshme për një përgjigje e thënë pa dëshirë, *Vërejtje Marku thatas*”.
- therr/ë-a** (10, 17, 30) “ferrë”. (Camaj përdor trajtën e së folmes së Dushmanit, që ndërron në ballë të fjalës *f*-në me *th*.”.)
- thij/ë-a** (21) “*thinjë*, qime floku e bardhë”.
- thimth-i** (43) “majë e hollë dhe e mprehtë që të shpon”.

- ulurim/ë-a** (20) “britmë e gjatë dhe e mprehtë, që përdoret edhe për të nxjerrë jashtë bishën nga strofka”.
- ungj-i** (21) “*unë-a, un-i, ur-i*, unë zjarri; trungjit e vënë në votër, të shkurtuar nga djegia”.
- urti-a** (22) “veprime të matura të një njeriu të edukuar e të nderuar”.
- ushël-i** (50) “mëshikë, fshikë, flluskë e mbushur me ujë që del në trup të njeriut, zakonisht nga të zënit pisk të lëkurës”.
- ushuj-i** (38) “dhjamë derri i shkrirë; dhjamë derri, që i nxirret nga barku, *e leu me ushuj derri*”.
- vajtor/e-ja** (67) “*vajtojçë*, grua profesioniste që ka zanat të qajë të vdekurit (në malësitë tona të Veriut)”.
- vedër-a** (31) “enë druri me madhësi të ndryshme, që përdoret për të mbajtur qumështin a për ta pritur atë kur milet bagëtia, *shkundi vedrën e madhe druni*”.
- verri-i** (32) “dru i madh që rritet pranë ujërave (*Alnus*); fruti i kësaj peme, *si lang verri janë të idhta*”.
- vetmitar** (16, 17, 43, 50, 51, 55) “njeri që jeton vetëm e i vetmuar”.
- vetmevete** (22) “me veten e vet”, neologjizëm i Camajt, krijuar si përngjitje nga *vetë me vete*.
- vërri-ni** (12, 22, 27) “*vërrí-a, vrrí*, kullotë dimërore”.
- vis-i** (21, 48, 52) “vend, *e kemi ble visin*”.
- vjegc/ë-a** (15, 42) “nyjë që nuk lidhet krejtësisht, po bën një hark mbi të, *e lypte dikund tjetër vjegcën e zbërthimit të fshehtësisë*”.
- vokë (me u)** (31) “vakem; as i nxehtë as i ftohtë (kryesisht për ujin), *kur u vok uji*”.
- vrangull** (62) “*ndf.* rreth e rrotull”.
- vrâ në vrâ** (56) “*ndf.* rryeshëm, ngadalë e me të vështirë, *S’e çon vrâ në vrâ punën*”.
- vutas** (10) “*ndf.* në mënyrë të sheshtë, të përvutë”.
- zbunim-i** (33) “të marrët me të mirë, me përkëdhelje”.
- zdatk-u** (50) “*çatmë*, mur i hollë me dërrasa që ndanë një dhomë në dy pjesë”.
- zeje** (38, 39) “mjeshhtëri, profesion”.
- zgërdhimje** (35) “përqeshje”.
- zhaurrim/ë-a** (48) “zhurmë e madhe e shkaktuar nga rrokullisja e gurëve ose rrjedha e fuqishme e lumit, *plasi zhaurrima e rrokullisjes së gurëve*”.
- zhgun-i** (23, 37, 39) “te Camaj me kuptimin e shajakut me të cilin punohen zhgunat, *teshat që kishte veshë Leka qenkan zhguni, tepër të vrashta për te*”.
- zhumhur/ë-a** (48) “zhurmë që vjen nga larg e si e mbytur”.
- zhurore** (20) “*mb.* që është me zhur”.